

Njoftim për përqendrim me të cilin ORBICO BULGARIA EOOD, Republika e Bullgarisë do të fitojë kontroll të pavarur mbi ESTE LAUDER BULGARIA EOOD, Republika e Bullgarisë

(Lënda nr. 08-15 /2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 15.01.2026, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin ORBICO BULGARIA EOOD, me seli në rr. Çeloneshko shose nr. 24, qyteti Sofje 1839, Rajoni i Sofjes, Republika e Bullgarisë, do të fitojë kontroll të pavarur mbi pasurinë objekt të transaksionit të ESTE LAUDER BULGARIA EOOD, me seli në Bulevardin Car Boris III nr. 159, 1618, Sofje, Republika e Bullgarisë.

– **ORBICO BULGARIA EOOD**, me objekt veprimtarie: veprimtari tregtare të brendshme dhe të jashtme, përfaqësim tregtar, ndërmjetësim, agjenci, shërbime – transportuese, spedicionere, konsulente, reklamuese, informatike, impresariale, servisuere, ndërtimore, projektuese, programore, marketing, si dhe të gjitha veprimtaritë e tjera që nuk janë të ndaluara me ligj dhe me aktet nënligjore përkatëse (fituesi).

Shoqëri që është në pronësi 100% të ORBICO SHPK për tregti, Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta nr. 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, me objekt veprimtarie: tregti, dhe e cila është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes:

– **Shoqërisë për tregti dhe shërbime ORBICO SHPK Shkup**, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Kisella Vodë – Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me objekt veprimtarie – tregti me shumicë e pa specializuar (si shoqëri në të cilën 96,463% e kapitalit është në pronësi të ORBICO SHP. për tregti, Zagreb).

Transaksioni i referohet fitimit të kontrollit të plotë mbi pjesë të caktuara të pasurisë dhe mbi pjesë të caktuara të veprimtarive afariste të:

– **ESTE LAUDER BULGARIA EOOD**, me objekt veprimtarie – veprimtari prioritare: import dhe eksport, tregti me shumicë, distribucion dhe shitje të kozmetikës prestigjioze, produkteve të tualetit, si dhe të gjitha veprimtarive të tjera që nuk janë të ndaluara me ligj.

ESTE LAUDER BULGARIA EOOD nuk ka prani korporative në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail:

kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

26.01.2026

Shkup